



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr.189/09

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Valon Totaj, me procesmbajtësen Drita Qerreti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit NTU (PTP) “...” Sh.A Prizren, të cilin e përfaqëson i autorizuari av. S.T, kundër të paditurve Qendra Mjekësore në Prizren dhe Ministria e Shëndetësisë – Agjencioni për Rregullimin e Barërave në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas propozimit të të autorizuarit të paditësit për përsëritjen e procedurës, me datën 21.04.2014, mori këtë:

A K T V E N D I M

Propozimi i paditësit NTU (PTP) “...” Sh.A Prizren, për përsëritjen e procedurës, hudhet poshtë **si i pa afatshëm**.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.189/09, të datës 24.11.2011, padia e paditësit NTU (PTP) “...” Sh.A Prizren, asokohe e përfaqësuar nga i autorizuari i saj av. B.N nga Prizreni, është konsideruar si e tërhequr, për shkak se në seancën e datës 24.11.2011, nuk kishte prezantuar i autorizuari i lartcekur i paditësit, edhe pse në shkresat e lëndës ka pasur prova se i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa që mungesën e tij nuk e kishte arsyetuar, më gjerësisht sikurse në këtë aktvendim.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AC.nr.3092/12, të datës 03.01.2014, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditësit av. B.N nga ... dhe është vërtetuar aktvendimi i atakuar i Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.189/09, të datës 24.11.2011, me arsye sikurse në këtë aktvendim. Në bazë të shkresave të lëndës, vërtetohet se këtë aktvendim i autorizuari i paditësit av. B.N nga ..., e kishte pranuar me datën 20.01.2014.

Me datën 15.04.2014, tani i autorizari i ri i paditësit av. S.T, pranë kësaj gjykate ka parashtruar propozimin për përsëritjen e procedurës, me arsye sikurse në këtë propozim.

Gjykata Themelore në Prizren, pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, si dhe propozimin e paditësit për përsëritjen e procedurës, të parashtruar nga tani i autorizuari i ri i tij av. S.T nga ..., në kuptim të nenit 237.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se propozimi për përsëritjen e procedurës **është i pa afatshëm**.

Në bazë të shkresave të lëndës vërtetohet se ish i autorizuari i paditësit av. B.N nga ... (ndaj të cilit ende nuk është tërhequr autorizimi, ndërsa që as ai nuk e ka denoncuar atë), e ka pranuar aktvendimin e Gjykatës së Apelit AC.nr.3092/12, të datës 03.01.2014, përmes të cilit është refuzuar ankesa e tij, me datën 20.01.2014. Në bazë të shkresave të lëndës del se ndërkohë, paditësi tani e ka autorizuar av. S.T nga ..., i cili me datën 15.04.2014, ka parashtruar pranë kësaj gjykate propozimin për përsëritjen e procedurës.

Me nenin 234.1 të LPK-së, ndër të tjera, parashihet se *“propozimi për përsëritjen e procedurës paraqitet brenda afatit prej 30 ditësh dhe atë në rastin nga nenin 232, pika a) e këtij ligji, që nga dita kur palës i është dorëzuar vendimi i formës së prerë...”*

Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se paditësi përkatësisht i autorizuari i tij av. Bashkim Nevzati, e ka pranuar aktvendimin e Gjykatës së Apelit AC.nr.3092/12, të datës 03.01.2014, përmes të cilit është refuzuar ankesa e tij si e pabazuar, me datën 20.01.2014, ndërsa i autorizuari i ri, tani av. S.T, e ka parashtruar propozimin për përsëritjen e procedurës me datën 15.04.2014, që i bie pas afatit ligjor 30 ditor.

Meqenëse në rastin konkret, paditësi e ka lëshuar afatin ligjor për të parashtruar mjetin e jashtëzakonshëm juridik – propozimin për përsëritjen e procedurës, bazuar në nenin 237.1 të LPK-së, propozimi i u deshtë të hidhet poshtë si i pa afatshëm.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.189/09, datë 21.04.2014

Procesmbajtësja,
Drita Qerreti

Gjyqtari,
Valon Totaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të tij, Gjykates së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.